

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 2, Tema: Prodhimi dhe standardet për produktet artizanale dhe ushqimore – eksperiencia sllovaqe dhe rastet praktike më të mira (Kapitulli 1)

e premte, 28 tetor 2022, 10:30 – 12:00

Hymeti Palace, Pogradec

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association dhe Shoqatën e Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare të Shqipërisë, me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në Sesionin 2 të Grupit të Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike) “Prodhimi dhe standardet për produktet artizanale dhe ushqimore – eksperiencia sllovaqe dhe rastet praktike më të mira (Kapitulli 1)” që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021- 2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministritë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të acquis së BE-së. Deri më tani janë organizuar më shumë se 40 sesione të grupeve përkatëse të punës dhe 4 aktivitete plenare, në të cilat ekspertë vendas dhe më shumë se 20 ekspertë nga Sllovakia kanë ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre. Këto sesione kanë mbledhur më shumë se 500 përfaqësues nga institucionet shtetërore (ministritë, institucionet publike qendrore dhe lokale), nga sektori i shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe shoqatat e punëtorëve, akademia dhe media, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizma të huaj dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: GP I – Gjqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III – Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); GP V – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20).

Në kuadër të Grupit të Punës V deri më tani janë organizuar 4 sesione me tema dhe fusha që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave, politikat industriale dhe njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Për periudhën 2021-2023 janë planifikuar të organizohen katër sesione për këtë GP.

**Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i gjuhës angleze*

PROGRAMI

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 2, Tema: Prodhimi dhe standardet për produktet artizanale dhe ushqimore – eksperiencia sllovake dhe rastet praktike më të mira (Kapitulli 1)

e premte, 28 tetor 2022, 10:30 – 12:00

Hymeti's Palace, Pogradec

10:15 – 10:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

10:30 – 10:45 Fjala e mirëseardhjes

Nirvana Deliu, Lëvizja Europiane në Shqipëri
Flutura Xhabija, Presidente, SHGPAZ

10:45 – 11:00 Sipërmarrja dhe prodhimi i produkteve ushqimore – shembull i Pogradecit

Entela Gusho, Nën-Kryetare e Bashkisë Pogradec

11:00 – 11:30 Prodhimi dhe standardet për produktet ushqimore

Ing. Viera Baričičová, PhD, eksperte, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Sllovaki

- Standardet Europiane për prodhimin e produkteve ushqimore/artizanale nga sipërmarrje t vogla – këshilla praktike për arritjen e tyre
- Mundësitë për shkëmbim tregtar dhe eksport (lëvizja e lirë e mallrave) – raste suksesi nga Sllovakia
- Roli i institucioneve shtetërore me fokus autoritetin lokal – Ofrimi për mbështetje financiare dhe teknike – fokus fondet europiane
- Bashkëpunim me sektorë të tjerë (universitet, dhoma e tregtisë) – si të fuqizohen këto biznese të vogla (nisma me fokus zhvillimin e grave sipërmarrëse)

11:30 – 12:00 Sfidat që hasin operatorët e biznesit për arritjen e standardeve për prodhimin e ushqimit

Komente dhe rekomandime nga ekspertët shqiptarë dhe aktorët kryesorë të këtij sektori

12:00 Mbyllja e takimit dhe koktejl